



Prishtinë: 27.12.2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1215\_2019

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1993\_10\_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **29.11.2019**.

### në seancën e mbajtur më datë 27.12.2019, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin B.B. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit **DPR – 90073377** si e pa bazuar.
- II **MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1993\_10\_19** i datës 31.10.2019.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 29.11.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: korrigjimi shtesë në vlerë prej 232.44€ është në përputhje të plotë me procedurat dhe kodet në fuqi, respektivisht nenin 4.11.1 të Kodit të Matjes së OSSH, pasi njëra fazë nuk ka regjistruar energji elektrike. Në ankesë theksohet se DMK e mbështet vendimin në raportin nga qendra e kalibrimit theksohet njëra fazë nuk regjistron energji dhe se gabimi është -31.66% ndërsa te po ai raport është tiku që thekson se njehsori nuk ka probleme me sisteme matëse, pra kemi vetëm gabim teknik, andaj kërkojnë nga Bordi që ta ketë parasysh këtë pasi që ka qenë vetëm gabim teknik. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_1993\_10\_19 të datës 31.10.2019 për konsumatorin B.B. me shifër DPR - 90073377.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se korrigjimi shtesë në vlerë prej 232.44€ është në përputhje të plotë me procedurat dhe kodet në fuqi, respektivisht nenin 4.11.1 të Kodit të Matjes së OSSH, pasi njëra fazë nuk ka regjistruar energji elektrike, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron



pasi që pasi pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës nuk ka vërejtur që njehsori të ketë regjistruar më herët më pak energji elektrike ashtu siç theksohet në procesverbalin e kalibrimit. Bordi i ZRRE-së thekson se në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0786488 të datës 12.01.2018, nuk është evidentuar asnjë defekt në njehsorin elektrik, si dhe gjithashtu është theksuar se ndërrimi bëhet me kërkesë me aplikacion. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0948379 të datës 28.02.2018 dhe se edhe në këtë procesverbal nuk është evidentuar asnjë defekt në njehsorin elektrik. Për të vërtetuar edhe më saktë se korrigjimi shtesë nuk është i saktë e dëshmon edhe fakti se në procesverbalin e kalibrimit nr.2984 të datës 02.02.2018 punëtorët e autorizuar të kalibrimit gjatë shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.38444303 kanë konstatuar se njehsori nuk është në rregull, njehsori nuk është i djegur, njehsori nuk është i dëmtuar nga ana e jashtme, njehsori nuk ka problem me sisteme matëse etj, si dhe dhënë një vërejtje ku kanë theksuar se: *“Njehsori elektrik ka të hapur kapakun kryesor me 10.08.2010, LED-i nuk është në vendin e vet dhe kur testohet në mënyrë manuale vërehet që në fazën L2 në tarife nuk regjistron fare energji elektrike dhe se gabimi në matje është -31.66%”,* por që në të njëjtin procesverbal fillimisht theksohet se njehsori nuk ka probleme me sisteme matëse, ndërsa në vërejtje është theksuar se kur njehsori testohet në mënyrë manuale në fazën L2 nuk regjistrohet energji elektrike. Pra, brenda një procesverbali kemi mospërputhje të konstatimeve të vet punëtorëve të KEDS-it. Për më tepër duhet theksuar në procesverbalin e kontrollimit teknik të Qendrës së Kalibrimit të KEDS nr.4803 të datës 22.02.2018 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë theksuar se njehsori bllobat i ka në rregull, nga ana e jashtme dëmtime nuk ka, si dhe në komisioni nuk ka mundur të vërejë ndonjë parregullsi, përderisa vlen të theksohet se në procesverbalin e kalibrimit nr.2984 të datës 02.02.2018 punëtorët e kalibrimit kanë konstatuar se njehsori elektrik ka të hapur kapakun kryesor me 10.08.2010, LED-i nuk është në vendin e vet dhe kur testohet në mënyrë manuale vërehet që në fazën L2 në tarife nuk regjistron fare energji elektrike. Pra Bordi i ZRRE thekson se nga analiza e këtyre procesverbaleve shihet qartë se ka mospërputhje, e për të cilat mospërputhje KEDS nuk ka dhënë asnjë sqarim në përgjigjen e tyre dhënë konsumatorit.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se në raportin e qendrës së kalibrimit theksohet njëra fazë nuk regjistron energji dhe se gabimi është -31.66% ndërsa te po ai raport është tiku që thekson se njehsori nuk ka probleme me sisteme matëse, pra kemi vetëm gabim teknik, Bordi i ZRRE-së thekson se edhe ky kundërshtim nuk është i saktë, pasi që ashtu siç theksua edhe më lartë, jo vetëm që brenda procesverbalit të kalibrimit nr.2984 të datës 02.02.2018 ka mospërputhje se a kanë qenë sistemet matëse duke regjistruar energji apo jo, pasi në njërin theksohet se nuk ka problem me sistemet matëse dhe pastaj theksohet se njehsori për një fazë nuk ka regjistruar energji, ka edhe mospërputhje edhe brenda procesverbaleve të qendrës së kalibrimit, si procesverbali i AMR & kalibrimit i shqyrtimit të njehsorit nr.2984 i datës 02.02.2018 dhe procesverbali i AMR & kalibrimit i kontrollimit detal nr.4803 i datës 22.02.2018.

Bordi i ZRRE po ashtu ka bërë analizimin e shpenzimeve të energjisë elektrike të konsumatorit dhe ka bërë krahasimin e shpenzimeve të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik nr.38444303 dhe me njehsorin nr.69674644, duke mos e përfshi periudhën kontestuese 11/2017, 12/2017 dhe 01/2018, dhe gjatë analizës ka vërejtur se nuk ka ndryshim të theksuar të shpenzimit të energjisë elektrike, madje Bordi i ZRRE-së thekson se pas ndërrimit të njehsorit konsumatori ka rënie të shpenzimit. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik nr.38444303 dhe njehsorin e ri elektrik nr.69674644 për periudha të njëjta kohore, konstatohet se nuk ka ndryshim të shpenzimeve. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.38444303 për periudhën 02/2016 deri në periudhën 12/2016 është **460.27 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.69674644 për periudhën 02/2018 deri në periudhën 12/2018 është **396.73 kWh/muaj**, e që kjo paraqet një rënie të shpenzimit prej 16.02%. Gjithashtu



duhet theksuar se është bërë edhe krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik nr.38444303 dhe me njehsorin nr.69674644 për periudha të njëjta kohore me periudhën kontestuese dhe kemi vërejtur se nuk ka ndryshim të shpenzimeve para dhe pas kontestit, por ka dallim vetëm me periudhën kontestuese. Bordi i ZRRE thekson se KESCO dhe KEDS në konstatimin e tyre të dhëna në procesverbalet e kalibrimit për konsumatorin kanë theksuar se njehsori elektrik nr.38444303 në fazën L2 në tarifë nuk regjistron fare energji elektrike dhe se gabimi në matje është -31.66%, mirëpo nga rrjedha e energjisë elektrike pas ndërrimit të njehsorit elektrik nuk është vërejtur se ka rritje të shpenzimit, e që po të kishte regjistruar energji më pak prej -31.66% shpenzimi i konsumatorit pas ndërrimit do të duhej të rritej e jo të ishte shpenzimi i njëjtë madje te rasti i konsumatorit kemi edhe zbritje të shpenzimit. Pra Bordi i ZRRE thekson se edhe ky është një fakt shumë i rëndësishëm se korrigjimi shtesë i KESCO bërë konsumatorit nuk është i saktë dhe si i tillë vendimi i organit të shkallës së parë ka qenë plotësisht i saktë dhe i drejtë.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit B.B. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.